

SISTEMIT I INFORMACIONIT SHËNDETËSOR

Ky modul synon përdoruesit që punojnë me sistemin e të dhënave të pacientit, të tillë si mjekët, infermierët dhe stafit mbështetës të kujdesit shëndetësor. Përcakton aftësitë e nevojshme për stafin që të operojë në mënyrë efikase dhe të sigurt, një sistem të informacionit shëndetësor (SISH). Njeh rëndësinë e edukimit dhe fuqizimit të përdoruesit të fundit në të gjitha nivelet dhe për të gjitha profesionet. E ndërton dhe plotëson arsimin profesional dhe atë praktik, dhe shkathtësitë e përgjithshme të Teknologjisë Informative për të mbuluar zonat gjithnjë e më të rëndësishme, ku aplikimi i sistemeve kompjuterike në sektorin e shëndetësisë mund t'i sfidojë që të dyja, praktikën e vërtetuar profesionale dhe menaxhimin e mire të të dhënave.

Me përfundimin e këtij moduli kandidati do të jetë në gjendje të:

- Kuptoj tiparet kryesore të një Sistemi të Informimit Shëndetësor (SISH).
- Përdor SISH (Sistemin e Informacionit Shëndetësor) në mënyrë të sigurt dhe efikase
- Kuptoj etikën, normat dhe rregullat që lidhen me përdorimin e SISH
- Kuptoj konfidencialitetin, sigurinë dhe kontrollin e qasjes në informata gjatë përdorimit të një Sistemi të Informacionit Shëndetësor
- Kuptoj dhe interpretoj në mënyrë elektronike të dhënat e regjistruara
- Për të mbrojtur pacientët dhe të dhënat e tyre

SI MUND TA MËSOJ KËTË MODUL?

Këtë modul mund ta mësoni nga librat dhe ushtrimet e librave në mënyrë autodidakte apo edhe duke ndjekur trajnimin e këtij moduli në ndonjë qendër testuese të ECDL-së. Për t'u përgatitur për provim ju rekomandojmë të ushtroni edhe me provimin mostër, të cilin mund ta shkarkoni nga ueb faqja jonë www.ecdl-kosova.org në linkun download.

Pasi ta keni mësuar këtë modul mund ta paraqitni provimin e këtij moduli në rubrikën Certifikimi.



Certifikatat e lëshuara nga ECDL Kosova vlejné ndërkombëtarisht.